



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

PJESA I E KONTRATËS:

Me date 09/10/2018 në mes të

KOMUNES SE PRISHTINËS, rruga: UÇK 2, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

NTSH Ekoinvest" adresa: Prishtinë, rruga: Agim Ramadani 511/9, me numër te regjistrimit te biznesit 707242251 dhe numër fiskal 600659786 ,përfaqësuar nga Lorik Kocani – projekt menaxher (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

"Mirëmbajtja e semaforëve ,invertorëve dhe pajimeve akustike për të verbërit në qytetin e Prishtinës"

Me numër identifikues: 616 17 111 211

Neni 1 Lënda

Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: "**Mirembajtja e semaforëve ,invertoreve dhe pajimeve akustike per te verberit ne qytetin e Prishtines**"

1.1 Lënda e kontratës publike kornizë është përcaktimi i kushteve, përfshirë çmimet e njësisë dhe rregullat e implementimit për sigurimin e shërbimeve të kësaj kontrate sipas Specifikimeve teknike dhe përshkrimit të shërbimeve nga Aneksi 1 i Specifikimeve Teknike të Detyrueshme që është pjesë e kësaj kontrate. Shërbimet nga kjo kontratë do të kryhen tek Autoriteti Kontraktues përkatësisht në nyjet semaforike te përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjëren prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdor këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Ofertuesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.5 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit nga të dy palët dhe përfundon pas kryerjes së shërbimeve nga pikë 1 në afatin maksimal deri në 36 muaj.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për fillimin e kryerje së shërbimeve do të jetë brenda çdo dite pune nga koha e lëshimit të urdhër blerjes përkatësisht. Kërkesës nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe do të vazhdoj deri në përfundimin e shërbimeve.

Afati i përfundimit nuk mund të jetë më i gjatë se 36 muaj nga data e fillimit të zbatimit të kontratës. Afati i përfundimit mund të jetë më i shkurtër nëse Autoriteti Kontraktues nuk është i kënaqur me shërbimet apo nëse ndonjë Vendim nga Organi më i lartë i Autoritetit Kontraktues përcakton ndëprerjen e shërbimeve të kontraktuara.

Afati i perfudnimit mund te jete me i shkurt se 36 muaj edhe ne rastin kur paraskadimit te afatit arrihet derivimi i lejuar prej (+30%).

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në qytetin e Prishtinës.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Çmimi total indikativ i shërbimeve nga kjo kontratë është: **149,961.00 €**
(Njëqinddedzetenëntëmijë e nëntëqinddegjashtëdhjetëenjëeuro e zeroeurocent)

3.2 Çmimi i përmendor në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

3.5 Kontrata nënshkruhet në vlerën e plotë indikative sipas Deklarates se nevojave dhe Disponueshmerise se mjeteve te aprovar nga zyrtaret kompetent dhe zotimit te mjeteve ne vlerë prej 75,300.00 €

Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative mund te jete (+, - 30%).

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;

- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsyet.

5.4. Komunikimet lidhur me menaxhimin e projekteve do të bëhen sipas Planit për menaxhimin e kontratës të paraparë me LLP-ik 04/I_042 dhe dokumenteve tjera dytësore-Rregullave te Prokurimit Publik dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

5.5 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në katër origjinale, tri originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin
Drejtori I Prokurimit	Zyrtari Kryesor Administrativ	
Emri: Zekë Bardhaj	Shpend Ahmeti	Emri: <i>JORIK KOGANI</i>
Pozita: Udhëheqës i Prokurimit	Kryetar I Komunës	Pozita: <i>LGBT PROJEKT MENAXHER</i>
Nënsh.	<i>Zemrë</i> <i>Oktimi</i>	Nënsh. <i>Cer</i>
Data: 28.12.2017	04/01/2018	Data: 09.01.2018
Vula:		Vula:



PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofroesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofroesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofroesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofroes i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofroesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshmë për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofroesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofroesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkuption të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkuption autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkuption Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkuption Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofroesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvëç në këto raste:
 - a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofroesit të Shërbimeve siguruesve të Ofroesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroesin e

Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër finanziar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroresi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofroresi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroresin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofroresi i Shërbimeve nuk duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontrakte ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofroresit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofroresi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofroresi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofroresi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofroresi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofroresi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

- (d) Ofrofresi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofrofresi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofrofresi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofrofresi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofrofresit të Shërbimeve, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofrofresi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofrofresit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruejë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofrofresit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njofitimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofrofresin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofrofresit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofrofresit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofrofresi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofrofresin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrofresi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofrofresin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofrofresit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofrofresi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofrofresi i Shërbimeve

10.1 Ofrofresi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofrofresit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhëni së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetave tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetave tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofriuesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofriuesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofriuesi i Shërbimit

15.1 Ofriuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohej në KVK.

15.2 Ofriuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofriuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofriuesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofriuesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbytjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofriuesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofriuesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit Kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofriuesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin Kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofriuesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tillë. AQP-ja mund të ndalojë

autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpérblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbllimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoresh, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit ose Ekipi për menaxhim të projektit dhe struktura e tij do të caktohen me Vendim të ZKA.
Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve		Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët. Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë menjëherë shërbimet sipas kësaj kontrate. Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet përkatëse në datën e planifikuar e dakorduar me Autoritetin Kontraktues. Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përektuar në pjesën e parë të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	10% i shumes totale te ofertës per 37 muaj
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11	Sipas obligimeve nga Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Pariemt e përgjithshme të pagesës		Autoriteti Kontraktues, do ti paguaj kontraktuesit shërbimet mujore te kryera ne muajin paraprak , në bazë të Konstatimeve te menaxherit apo ekipit menaxhues.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Menaxheri i caktuar nga Komuna
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Tribunali i përhershëm i arbitrazhit pranë Odes Ekonomike
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente-Gjykatën Komunale në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Mirëmbaitja e semaforëve, invertorëve dhe pajimeve akustike për të verberit në qytetin e Prishtinë

Nr. Ren	Përshkrimi i materialit	Njësia	Sasia	Çmimi njesi TVSh	Shuma me TVSh
1	Furnizimi dhe montimi i Laternës vozitëse tri piesëshe (të automjeteve) Ø 300 me dioda të TIP-it, "LED HIGH FLUX Luxeon Lumileds 230 V, shpenzimi max. 9 Ëatt", me demontim të së vjetrës Karakteristikat teknike: EMC: EN50293 class B IP55, Class IV Temp. E operimit: -40°C, + 60°C	copë	3	540.00	1620.00 €
2	Furnizimi dhe montimi i Laternës vozitëse tri piesëshe (të automjeteve) Ø 200 me dioda të TIP-it, "LED HIGH FLUX Luxeon Lumileds 230 V, shpenzimi max. 9 Ëatt", me demontim të së vjetrës Karakteristikat teknike: EMC: EN50293 class B IP55, Class IV Temp. E operimit: -40°C, + 60°C	copë	3	510.00	1530.00 €
3	Furnizimi dhe montimi i Laternës dy piesëshe të këmbsorve Ø 200			470.00	1410.00 €

B28 Dosja e Tenderit për Kontraten Publike Kornizë – Shërbim

	mm me dioda të TIP-it "LED HIGH FLUX Luxeon Lumileds 230 V, shpenzimi max. 9 Ëatt", me demontim të së vjetrës pas dëmtimit eventual dhe pastrim të tërsishëm të terenit. Karakteristikat teknike: EMC: EN50293 class B IP55, Class IV Temp. E operimit: -40°C, + 60°C	copë	3		
4	Vendosja e armaturave (laternave) vozitëse plotësuese (njëpjesës)e \varnothing 300 mm, me dioda të TIP-it "LED HIGH FLUX Luxeon Lumileds 230 V, shpenzimi max. 9 Ëatt", me demontim të së vjetrës pas dëmtimit eventual dhe pastrim të tërsishëm të terenit. Karakteristikat teknike: EMC: EN50293 class B IP55, Class IV Temp. E operimit: -40°C, + 60°C	copë	3	50.00	150.00 €
5	Furnizimi dhe montimi i numeruesëve Count Doën Modul \varnothing 300 per automjete i teknologjise LED dhe komunikues i tipit RS 485, me 3 rradhe te numrave max deri 199 (lartesia H 18 cm), me demontim të së vjetrës pas dëmtimit eventual dhe pastrim të tërsishëm të terenit. Temperatura e operimit: -40°C, + 70°C Acc. EN12368 Shkalla e mbrojtjes IP 65. Acc EN60598 EMC: acc. EN50293	copë	3	250.00	750.00 €
6	Furnizimi dhe montimi i numeruesëve Count Doën Modul \varnothing 200 per këmbësori i teknologjise LED dhe komunikues i tipit RS 485, me 2 rradhe te numrave max deri 99 (lartesia H 12,5 cm), me demontim të së vjetrës pas dëmtimit eventual dhe pastrim të tërsishëm të terenit. Temperatura e operimit: -40°C, + 70°C Acc. EN12368	copë	3	200.00	600.00 €

	Shkalla e mbrojtjes IP 65. Acc EN60598 EMC: acc. EN50293						
7	Furnizimi dhe montimi i pjaisjeve me button për kontrollim nga këmbësorët (Push Button), me demontim të së vjetrës pas dëmtimit eventual dhe pastrim të tërsishëm të terenit.				10.00	200.00 €	
8	Furnizimi dhe montimi i pjaisjeve me detektor dy kanalesh per menagjimin e nyjeve induktive, me demontim të së vjetrës pas dëmtimit eventual dhe pastrim të tërsishëm të terenit.	copë	20		5.00	25.00 €	
9	Furnizimi dhe montimi i pjaisjeve video detektore, per detektimin e mjeteve neper udhehkyqe, me demontim të së vjetrës pas dëmtimit eventual dhe pastrim të tërsishëm të terenit. Karakteristikat teknike:	copë	5		10.00	50.00 €	
10	- Teknologja: Bardh e zi Cmos - Madhesia e senzorit 1/4" - Rezolucioni 640x480 pixela (VGA) - 20 frema per second - Distanca fokale 2.1 mm - Fusha e dukshmerise: horizontale 99°, vertikale 83°, nga kendi në kend 111°. - Furnizimi me rryme 12-26 AC/DC - Konsumi elektrik <85mA, 12VDC dhe 50 mA 24VDC - RS-485 porti komunikues	copë	5		5.00	25.00 €	
11	Riparimi i llaternave të dëmtuara të vozitësve, ϕ 300 me dioda të TIP-it, "LED HIGH FLUX Luxeon Lumileds.	copë	5		5.00	25.00 €	
12	Riparimi i llaternave të dëmtuara të kembesoreve, ϕ 200 me dioda të TIP-it, "LED HIGH FLUX Luxeon Lumileds.	copë	5		5.00	25.00 €	


13	Furnizimi dhe montimi i poçit LED " High Flux" i montuar në thierren \varnothing 300 mm.				5.00	5.00	150.00
14	Furnizimi dhe montimi i poçit LED " High Flux" i montuar në thierren \varnothing 200 mm.				5.00	5.00	150.00
15	Furnizimi dhe montimi i objektivit te videodetektorit, <ul style="list-style-type: none"> - Teknologjia: Bardh e zi Cmos - Madhesia e senzorit 1/4" - Rezolucioni 640x480 pixela (VGA) - 20 frema per second Furnizimi dhe montimi i kuadrit komandues kryesor, i tipit RSC 72 Lasemaforica ose e ngjajshme kompatibil , me keto Karakteristika teknike: Grupe te sinjaleve: 32 me mundesi zgjerimi ne 42 Ngarkesa maksimale per rreje dalje: 800 Ëatt Hyrje digitale: 32 Dalje digitale: 32	copë	30	copë	30	5.00	150.00 €
16	Se paku 16 plane te sinjaleve te mund te vendosen I pajisur me LCD display Te kete mundesine e centralizimit me sistemet PASPA, SIGMA, UTOPIA, TMACS. Mundesi te lidhjese me GPRS Mundesi te lidhjese me GPS Te kete mundesin e gjenerimit dinamik te planeve. Te jete i punuar sipas standartit UNI EN 12675 Struktura e tij duhet te jetë modulare Furnizimi dhe montimi i panelit LCD te kontrollorit RSC 72 Lasemaforica ose e ngjajshme kompatibil me 80 karaktere.	copë	10	copë	10	5.00	50.00 €
17		cope	2	cope	2	10.00	20.00 €

18	Furnizimi dhe montimi i modulit te furnizimit me energji elektrike te kontrollerit. Tipi: RSC ALI 9194, Lasemaforica ose e ngjajshme kompatibile	copë	5		10.00	50.00 €
19	Furnizimi dhe montimi i modulit te fazave. Tipi: RSC OUT 04301, Lasemaforica. se e ngjajshme kompatibile	copë	5		10.00	50.00 €
20	Furnizimi dhe montimi i modulit te procesorit CPU Tipi: RSC CPU32_V5, Lasemaforica. se e ngjajshme kompatibile	copë	5		10.00	20.00 €
21	Furnizimi dhe montimi i modulit TA Tipi: RSC TA 2212, Lasemaforica. se e ngjajshme kompatibile	copë	2		10.00	20.00 €
22	Furnizimi dhe montimi i modulit te detektorit Tipi: RSC DET32_V4, Lasemaforica. se e ngjajshme kompatibile	copë	10		10.00	100.00 €
23	Furnizimi dhe instalimi i siguresës automatike Tipi: Siemens RCBO C25 300mA se e ngjajshme kompatibile	copë	10		10.00	100.00 €
24	Furnizimi dhe instalimi i siguresës automatike Tipi: Siemens RCBO 20A se e ngjajshme kompatibile	copë	10		10.00	100.00 €
25	Furnizimi dhe instalimi i siguresës automatike Tipi: Siemens RCBO C16 30mA se e ngjajshme kompatibile	copë	10		10.00	100.00 €
26	Furnizimi dhe instalimi i trafos 230-12v dhe 230-24v ne kontroller. Tipi:	copë	10		10.00	100.00 €
27	Furnizimi dhe instalimi i shkarkueseve te mbitioneit. Tipi: Siemens 5SD7 UC 350V se e ngjajshme kompatibile	copë	10		10.00	100.00 €

28	Furnizimi dhe instalimi i riderituesit 12V/1.67A	copë	10	10.00	100.00
29	Furnizimi dhe montimi i kapakëve te shtylla semaforike	copë	30	10.00	300.00 €
30	Furnizimi dhe instalimi i pocit Semaforik 75E, i TIP-it GE, i vendosur në fyt E-27.	copë	20	10.00	200.00 €
31	Sigurimi dhe montimi i pocit Hallogen H412V 55E, PKX	copë	20	1.00	20.00 €
32	Furnizimi dhe instalimi i siguresës Vikman 6,3 ose 16A	copë	10	1.00	10.00 €
33	Furnizimi dhe instalimi i siguresës automatike 6,10 ose16A	copë	10	1.00	10.00 €
34	Furnizimi dhe instalimi i fytit të pocit E-27 me Dado	copë	10	1.00	10.00 €
35	Furnizimi dhe instalimi i trafos për Laterna 220/12V	copë	10	1.00	10.00 €
36	Furnizimi dhe instalimi i harkut të Laternës PVC	copë	20	10.00	200.00 €
37	Furnizimi dhe instalimi i mburojës për Ø 300 ose Ø 210 mm, PVC e zezë	copë	30	1.00	30.00 €
38	Ndrimi i trekëndëshit të llaternës	copë	20	1.00	20.00 €
39	Ndrimi i shtëpizës së llaternës	copë	20	1.00	20.00 €
40	Furnizimi dhe montimi i shtyllës gjysmeportle me te gjitha pjeset dekorative. Sipas skices /gjysmeportalji/. Shtylla duhet te jetë e galvanizuar sipas standartit TS 914 EN ISO 1461, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005	copë	1	50.00	50.00 €
41	Furnizimi dhe montimi i shtyllës vertikale te gjysmeportalit, sipas skices . Shtylla duhet te jetë e galvanizuar sipas standardit TS 914. Sipas skices /gjysmeportalji/. EN ISO 1461, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005	copë	1	50.00	50.00 €



	Furnizimi dhe montimi i krahut te gjysmeportalit, sipas skices . Shtylla duhet te jetë e galvanizuar sipas standardit TS 914 EN ISO 1461, Sipas skices /gjysmeportal/./. E ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005	copë	1	50.00	50.00 €
42	Furnizimi dhe montimi i Portalit komplet, sipas skices /Portali 1/.	copë	1	50.00	50.00 €
43	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te Portalit, sipas skices /Portali 1/.	copë	1	50.00	50.00 €
44	Furnizimi dhe montimi i trareve horizontal te Portalit, sipas skices /Portali 1/.	copë	1	50.00	50.00 €
45	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te automjeteve 3.2 m, sipas skices /Shtylla e automjeteve/. Shtylla duhet te jetë e galvanizuar sipas standardit TS 914 EN ISO 1461, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005	copë	1	50.00	50.00 €
46	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te automjeteve 4.2 m, sipas skices /Shtylla e automjeteve/. Shtylla duhet te jetë e galvanizuar sipas standardit TS 914 EN ISO 1461, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005	copë	5	450.00	2250.00 €
47	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te kembesoreve 3.2 m, sipas skices /Shtylla e kembesoreve/. Shtylla duhet te jetë e galvanizuar sipas standardit TS 914	copë	5	550.00	2750.00 €
48	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te kembesoreve 3.2 m, sipas skices /Shtylla e kembesoreve/. Shtylla duhet te jetë e galvanizuar sipas standardit TS 914	copë	5	150.00	750.00 €



	EN ISO 1461, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005				
49	Furnizimi dhe montimi i kapakeve dekorativ per shtyllat gjysmepartale te punuar nga alumin i derdhur, te ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005 /gjysmepartali/.	copë	5	10.00	50.00 €
50	Furnizimi dhe montimi i kapakeve dekorativ per shtyllat e automjeteve dhe kembesoreve te punuar nga alumin i derdhur, te ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005 /Shtylla e automjeteve/.	copë	5	10.00	50.00 €
51	Furnizimi dhe montimi i kapakut te siperm dekorativ per shtyllat gjysmepartale te punuar nga alumin i derdhur, te ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005 /gjysmepartali/.	copë	5	10.00	50.00 €
52	Furnizimi dhe montimi i kapakut te siperm dekorativ per shtyllat e automjeteve dhe kembesoreve te punuar nga alumin i derdhur, te ngjyrosur me ngjyre elektrostatike. RAL 9005. /Shtylla e automjeteve/.	copë	5	10.00	50.00 €
53	Drejtimi i shtyllës së lakuar 3.20 – 4.00 m	copë	10	10.00	100.00 €
54	Furnizimi dhe instalimi i <u>kablos 7x1.5mm²</u>	m	100	1.00	100.00 €
55	Furnizimi dhe instalimi i <u>kablos 4x1.5mm²</u>	m	100	1.00	100.00 €
56	Furnizimi dhe instalimi i <u>kablos 5x2.5mm²</u>	m	300	0.20	60.00 €
57	Furnizimi dhe instalimi i <u>kablos 3x2.5mm²</u>	m	300	0.20	60.00 €
58	Furnizimi dhe instalimi i kablos <u>24 x1,5 mm²</u> për sinjal.	m	500	0.20	100.00 €
59	Furnizimi dhe instalimi i <u>fiksionit FID 25A / 0,5°</u>	copë	5	1.00	5.00 €
60	Rregullimi (riparimi) i kontaktit të mbëshqellur, <u>Volphram, AG 1957</u>	copë	20	1.00	20.00 €
61	Rregullimi (riparimi) i <u>Cikrikut PSV 17409</u>	copë	15	1.00	15.00 €
62	Rregullimi (riparimi) i <u>Relesë Sullobë KSLBT</u>	copë	6	1.00	6.00 €
63	Furnizimi dhe instalimi i <u>Rendoreve 16 KV</u>	copë	20	1.00	20.00 €

64	Rregullimi (riparimi) i Moduleve POË, DISP, CPU, DFOB, NET, VOZ, LGVC, LGBAT dhe IPOA.	copë	10	1.00	10.00 €
65	Furnizimi dhe instalimi i Konektorit "mashkull" ose "femër" IPOA – IPOB	copë	6	1.00	6.00 €
66	Pajisja per menagjimin e hyrje-daljeve, shtyllje hidraulike automatike. Karakteristikat teknike: <i>Menyra e levizjes: Hidraulike automatike</i> <i>Tipi i cilindrit levizes: Steel FE 37 – trashesia 4-6 mm</i> <i>Pajisjet ne te cilat leviz cilindri: Polyester me ngjyre plastike</i> <i>Diametri i cilindrit levizes: 220-275 mm</i> <i>Lartesia e cilindrit nga toka: 600 mm</i> <i>Pjesa e siperme e cilindrit: Alumin</i> <i>Shpejtësia e ngritisë: 10-20 cm/s</i> <i>Shpejtësia e uljes: 10-20 cms</i> <i>Pompa hidraulike: 230V 50Hz</i> <i>Kondensatori i pompes: 10 µF – 16 µF</i>	copë	1	600.00	600.00 €
67	Pajisja per menagjimin e hyrje-daljeve, shtyllje Fikse Karakteristikat teknike: <i>Menyra e levizjes: Fikse</i> <i>Tipi i cilindrit fiks: Steel FE 370 – trashesia 4-6 mm</i> <i>AISI 304 Stainless Steel</i> <i>Diametri i cilindrit levizes: 220-275 mm</i> <i>Lartesia e cilindrit nga toka: 600 mm</i> <i>Pjesa e siperme e cilindrit: Alumin</i>	copë	1	600.00	600.00 €
68	Pajisjet e kontrollit per shtyllat automatike hidraulike Karakteristikat teknike: Duhet te kete micro processor qe e perkrah instalimin e softuerit per	copë	1	150.00	150.00 €

	menagjim, Shkalla e mbrojtjes: IP55 Temp e operimit: -15C +70 C Furnizimi me energji elektrike: 230 V 50 Hz Te kete mundesine e lidhjes deri ne 10 shtylla per menagjum.				
69	Modemi Gsm per monitorim dhe kontroll nga qendra e monitorimit te qytetit te Prishtines.	copë	1	50.00	50.00 €
70	Tele dirigjues per ngrutjen edhe uljen e shtyllave	copë	1	50.00	50.00 €
71	Shtylla per montimin e kontrollerit dhe pajisjeve tjera te nevojshme per menagjim.	copë	1	10.00	10.00 €
72	Riparimi i shtyllave automatike dhe pajisjeve te kontrollit	copë	1	50.00	50.00 €
73	Ndërtimi i bazës së shtyllës, gropimi i dheut, transporti, vendosja e ankerave me bulona M 24, dy gypa PVC Ø 50mm, me beton MB 30 me dim. 0,80x0,80x1,00m Komplet:	copë	1	20.00	20.00 €
74	<p>Pastrimi nga pluhuri në të gjitha llojet e llaternave Semaforike shtyllave etj në bazë të urdhresës së org. Mbikqyrës. Llogaria përfshinë pastrimin e qelqit (nga ana e mbrendshme dhe e jashtme), shtyllave, llaternave dhei i pjesëve tjera sipas nevoja për pastrim. Çmimi të llogaritet për një nyje Semaforike të një udhikryqi. Komplet.</p> <p>Grupi 1</p> <p>Udhekryqet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti filologjik (Semaforet kryesor) 2. Menza e studenteve 3. Fakulteti Teknik 4. U. Bill Clinton 5. U. Rr. 1 tatori – Nazmi Gafurri 6. U. Rr. UCK-Tirana (Kafet e Vogla) 7. U. Rr. Luan Haradinaj – rr. Garibaldi 	muaj	12	30.00	360.00 €

	Pastrimi nga pluhuri në të gjitha llojet e llaternave Semaforike shtyllave etj në bazë të urdhresës së org. Mbikqyrës. Llogaria përfshinë pastrimin e qelqit (nga ana e mbrendshme dhe e jashtme), shtyllave, llaternave dhe i pjesëve tjera sipas nevoja për pastrim. Çmimi të llogaritet për një nyje Semaforike të një udhëkryqi. Komplet.	muaj	12	30.00	360.00 €
75	Grupi 2 Udhekryqet:				
76	8.U.Stacioni 9.U.Fak. Ekonomik 10.U.Parlamenti 11.U.Santea 12.U.Iir Konushevci-Lidhja e Prizrenit 13.U.UCK - Migjeni Ngjyrosja e shtyllave për snjalizim. Komplet për një nyje semaforike me ngjyrë që e përcakton norganin mbikqyrës.	copë	10	20.00	200.00 €
77	Ngjyrosja e ormanit (kasetës)	copë	3	5.00	15.00 €
78	Nderhyrja, intervenimi dhe kontrolli ne cdo kohe brenda 24 oreve, Shqyrtimi i instalimit të nyjes semaforike komplet pas dëmtimit, vetëm me lejen e organit mbikqyrës.	dité	365	72.00	26 280.00 €
79	Ndrimi i programit të punës dhe koordinimi i tyre për një nyje semaforike në bazë të urdhërës së organit mbikqyrës.	paushall	1	400.00	400.00 €
80	Furnizimi dhe instalimi i tregueseve e shpejtësise,	paushall	1	400.00	400.00 €
81	Riparimi i radareve te shpejtësise	cope	2	200.00	400.00 €
82	Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve per furnizim me energji te radareve te shpejtësise	cope	2	200.00	400.00 €
83	Furnizimi dhe montimi i monitorimeve ne qendren e monitorimit	cope	2	150.00	300.00 €
84	Riparimi i monitorimeve ne qendren e monitorimit	cope	1	150.00	150.00 €
85	Porosia dhe montimi i Bateris (akumulatorit) industrial 200 A.	cope	1	150.00	150.00 €
86	Komplet me lidhje dhe material tjetër të nevojshëm	copë	2	200.00	400.00 €

87	Porosia dhe montimi i Bateris (akumulatorit) industrial 100 A.						
88	Komplet me lidhje dhe material tjetër të nevojshëm						
89	Furnizimi dhe montimi me invertor Tipi: Tripp Lite APSX1012SE pure sineave se e ngajaishme kompatibile						
90	Ndrimi i paimeve që nuk janë përfshirë më lartë, paguhën në bazë të Faturës të paraqitur për blerjen e materialit nga prodhuesi me të gjitha shpenzimet eventuale Doganore etj. sipas urdhresës, vërtetimit të faturës dhe pranimit nga organi mbikqyrës.						
91	Projektimi dhe instalimi i programit CMS per monitorim(shih pershkrimin në sqarim)						
	GJITHSEJT						
		copë	2	200.00	400.00 €		
		copë	5	10.00	50.00 €		
		copë	2	150.00	300.00 €		
				200.00	200.00 €		
		Paushall	1				
		Paushall	1	2000.00	2 000.00 €		
					49 987.00 €		

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	N.T.SH. EKOINVEST
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFQËSUESIT	LORIK KOCANI
TE OE:	
NËNSHKRIMI:	
DATA:	30.10.2017
VULA:	